

V E N D I M
Nr.760, datë 11.11.1996

PËR PRIVATIZIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE NË SHOQËRITË TREGTARE

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paktë aksionesh në këtë vendim do të kuptohet numri i aksioneve, si përqindje e kapitalit themeltar, në shoqëritë tregtare, ku shteti, si pronar i vetëm i kapitalit, përfaqësohet nga Ministria e Privatizimeve. Kjo paketë i vihet në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Privatizimit për shitje në favor të një blerësi të vetëm.

2. Blerës në këtë vendim kuptohet një person fizik ose juridik.

3. Ministria e Privatizimeve përcakton madhësinë e paketës së aksioneve për privatizimin dhe e vë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, së bashku me dokumentacionin përkatës të shoqërisë.

4. Forma e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërive tregtare është ankandi. Ankandi për privatizimin e paketës së aksioneve realizohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

Konsiderohet fitues i ankandit për paketën e aksioneve ai pjesëmarrës që ofron çmimin më të lartë.

5. Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon procedurën e shitjes jo më shumë se 15 ditë pas marrjes së urdhrat dhe dokumentacionit për privatizim, nga Ministria e Privatizimeve, të paketës së aksioneve.

6. Procedura e shitjes fillon me publikimin për shitjen e paketës së aksioneve. Publikimi bëhet në jo më pak se tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën 9 herë. Afati i publikimit do të jetë jo më pak se 45 ditë. Dita dhe ora e zhvillimit të ankandit janë pjesë e publikimit.

7. Me fillimin e ankandit, pjesëmarrësit i dorëzojnë komisionit të ankandit dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për pjesëmarrje në privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë.

2. Dokumentacionin bankar që vërteton pagesën paraprake të 20 për qind të vlerës së paketës së aksioneve në lekë.

8. Komisioni i ankandit përbëhet nga:

Kryetar- Përfaqësues i AKP

Anëtar- Përfaqësues i Ministrisë së Privatizimeve

Anëtar - Përfaqësues i shoqërisë tregtare, paketa e së cilës privatizohet.

9. Fitues i ankandit është personi fizik ose juridik që deklaron çmimin më të lartë. Pas deklarimit të fituesit të ankandit, pjesëmarrësit e tjerë në ankand kanë të drejtë të japin çmimin maksimal të mundshëm të përballueshëm prej tyre. Komisioni harton listën e pjesëmarrësve sipas radhës së ofertave (çmimi më i lartë i pari e kështu me radhë), e cila firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe është pjesë e procesverbalit të mbajtur prej tyre.

10. Ditën e ankandit fituesit i lëshohet autorizimi për kalim pronësie të paketës së aksioneve. Afati i pagesës së çmimit të ofruar është 30 ditë nga data e lëshimit të autorizimit.

11. Çdo pjesëmarrës në ankand (përveç fituesit) do të konsiderohet “fitues i mundshëm” në rast tërheqjeje nga pjesëmarrësit paraardhës sipas listës.

12. Pjesëmarrësve të tjerë (përveç fituesit të radhës) i kthehet 20% e vlefës fillestare të paguar paraprakisht, sipas vullnetit të shprehur prej tyre me shkrim.

13. Për fituesit e ankandeve, të cilët nuk kryejnë pagesën brenda afateve të përcaktuara, si dhe kur tërhiqen brenda këtij afati, u mbahet 20 për qind e vlefës fillestare të paguar paraprakisht si e ardhur në buxhet. Atëherë fitues i ankandit shpallet personi fizik ose juridik pasardhës në listë.

14. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Privatizimeve dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi